

KREDI ME PENG DEPOZITE FLETË E STANDARTIZUAR E INFORMACIONIT PARAKONTRAKTOR

Zërat	Përshkrimi
Teksti prezantues	Ky dokument nuk përbën një ofertë ligjore detyruese. Shifrat janë dhënë në mirëbesim dhe janë një prezantim i saktë i ofertës që banka do të bëjë sipas kushteve aktuale të tregut, bazuar në informacionin e dhënë. Megjithëkëtë, këto shifra mund të luhaten sipas kushteve të tregut. Dhënia e këtij informacioni nuk përbën detyrimin e kësaj të fundit për të akorduar kredi.
1. Banka	BANKA KOMBETARE TREGTARE (BKT) SH.A Adresa: Bulevardi "Rruga Vilave", Lundër 1, Tiranë Numri i telefonit: 042 266 288 Adresa e web-it: www.bkt.com.al Email: info@bkt.com.al
2. Emri i Produktit	Kredi me Peng Depozite/Titujsh Qeveritarë
3. Lloji i Kredisë	Kredi individuale e siguruar me peng depozite/Titujsh Qeveritarë
4. Qëllimi i produktit	Nëpërmjet kredive me peng depozite/titujsh qeveritare synohet të përmbushen nevojat personale të klientëve të cilët kanë mundësinë e ofrimit të një garancie në kesh (depozitë, Bono Thesari apo Obligacion).
5. Përshkrimi i produktit	<p>Ky produkt përdoret për qëllimin e parashikur në pikën 4 ku si garanci banka do të kërkojë barrësim (bllokim) të depozitës, Bonos së Thesarit apo Obligacionit. Depozita apo Titulli i ofruar mund të jetë në emër të klientit ose në emër të një personi të tretë. Në rastin e dytë dorëzania e personit të tretë është e nevojshme. Për Bonot e Thesarit dhe Letrat me Vlerë nevojitet çertifikata origjinale e lëshuar nga BKT së fundmi.</p> <p>Vlera e përllogaritur e depozitës në momentin e aprovimit do të jetë minimum 110% e vlerës së kredisë së akorduar, nëse monedha e Kredisë do të jetë e njëjtë me monedhën e Depozites, në rast të kundërt vlera e përllogaritur do të jetë 120%.</p> <p>Vlera e Tregut për Bonot e Thesarit dhe Letrat me Vlerë duhet të mbulojë 111% të shumës së kredisë.</p> <p>-Nëse mbajtësi i depozitës është i ndryshëm nga kredikërkuesi shlyerja e kredisë do të kryhet me këste të barabarta mujore (kryegjë + interes) sipas aneksit të shlyerjes dhe jo si shlyrje e njëhershme në fund të afatit të maturimit.</p> <p>-Nëse mbajtësi i depozitës është i njëjtë me kredikërkuesin shlyerja e kredisë mund të bëhet sipas kërkesës së klientit: ose me këste të barabarta mujore (kryegjë + interes) ose me shlyerje të njëhershme të principalit në fund të afatit të maturimit.</p> <p>Nuk është e nevojshme pjesmarrja e klientit.</p>
6. Norma e interesit (tregon llojin e interesit dhe kohëzgjatjen e periudhës së përcaktuar)	<p>A. Normat e Interesave të kredisë me peng depozite: Për kredi me maturim deri në 5 vite, norma e interesit do të jetë:</p> <ol style="list-style-type: none">Nëse zgjidhet fikse, do të llogaritet si shumë e normës së interesit e publikuar në Buletinin e Normave të Interesit të depozitave të së njëjtës monedhë (referuar shumës maksimale) dhe kohëzgjatje dhe marzhit si më poshtë: Kredi në LEK: Normë depozite+ 1.5% Kredi në EUR/USD: Normë Depozite +1.7%Nëse do të zgjidhet variabël, do të jetë: Lek : B-Th + 1%, jo më pak se 3% Euro : Euribor + 1%, jo më pak se 3% Dollar Amerikan : Sofr + 1%, jo më pak se 3%

	<p>Për kredi me maturim më të lartë se 5 vite, norma e interesit do të jetë fikse për 5 vitet e para të përcaktuar sipas formulës së mësipërme, më pas do të jetë e ndryshueshme sipas tabelës më poshtë:</p> <table border="1" data-bbox="453 506 1310 678"> <thead> <tr> <th rowspan="2">Monedha</th> <th rowspan="2">Formula</th> <th colspan="2">Norma minimale e aplikuar sipas maturitetit të kredisë</th> </tr> <tr> <th>Nga 5 deri në 10 vjet</th> <th>Mbi 10 vjet</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>LEK</td> <td>BTH + 1%</td> <td>3.5%</td> <td>4%</td> </tr> <tr> <td>Euro</td> <td>Euribor + 1%</td> <td>3%</td> <td>3%</td> </tr> <tr> <td>USD</td> <td>Sofr+ 1%</td> <td>3.5%</td> <td>3.5%</td> </tr> </tbody> </table> <p>B. Normat e Interesave për kredi me peng Bono Thesari /Obligacioni: LEK – Bono Thesari 1 vjeçare +1.5% jo më pak se 3.5% <i>Në rastet kur kredia konvertohet në kredi me peng depozite, Normat e Interesit të kredisë nuk duhet të jenë më pak se Normat e Interesit të Depozitës +1.5% ose B-Th + 1%, jo me pak se 3%.</i></p> <p>Norma e ofruar e interesit është e ndryshueshme sipas luhatjeve të Bonove të Thesarit, Euribor-it dhe Libor-it me afat 1-vjeçar, çdo 12 muaj të kredisë. Aplikanti do të informohet nëpërmjet telefonit, postës elektronike ose me postë për çdo ndryshim në kushtet dhe termat e kontratës së kredisë.</p>	Monedha	Formula	Norma minimale e aplikuar sipas maturitetit të kredisë		Nga 5 deri në 10 vjet	Mbi 10 vjet	LEK	BTH + 1%	3.5%	4%	Euro	Euribor + 1%	3%	3%	USD	Sofr+ 1%	3.5%	3.5%
Monedha	Formula			Norma minimale e aplikuar sipas maturitetit të kredisë															
		Nga 5 deri në 10 vjet	Mbi 10 vjet																
LEK	BTH + 1%	3.5%	4%																
Euro	Euribor + 1%	3%	3%																
USD	Sofr+ 1%	3.5%	3.5%																
<p>7. Norma efektive e interesit</p>	<p>Norma efektive e interesit (NEI) shpreh totalin e kostos së kredisë duke përfshirë dhe interesat, komisionet dhe çdo lloj tjetër shpenzimi që kredimarrësi paguan në lidhje me kontratën e kredisë. Për qëllime të llogaritjes së NEI totali i kostos së kredisë nuk përfshin shpenzime që nuk njihen në datën e llogaritjes së NEI, shpenzime të pagueshme nga kredimarrësi të detyrimeve për moszbatimin e kushteve të parashikuara në kontratë, kostot e pagueshme nga kredimarrësi lidhur me marrëveshjen e kredisë për persona të tjerë (për shembull, tarifat noteriale, tarifat e Zyrove Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, tarifat e Regjistrimit të Barrëve Siguruese, të përcaktuara sipas akteve përkatëse) dhe çdo shpenzim në përgjithësi të detyruar për regjistrimin dhe garancitë; shpenzimet për siguracionin dhe/ose garancitë që nuk janë të detyrueshme, shpenzime për komisione të aplikuara për fondet e papërdorura dhe shpenzime komisionesh për ndryshim të kushteve kontraktore. NEI do të llogaritet me supozimin që :</p> <ul style="list-style-type: none"> - kontrata kredisë është e vlefshme për periudhën e rënë dakord, dhe - palët plotësojnë detyrimet e tyre, sipas kushteve dhe datës së rënë dakord në kontratën e kredisë, dhe - përqindjet e interesit dhe shpenzimet e tjera që përfshihen në llogaritjen e NEI mbeten të pandryshuara deri në fund të kontratës së kredisë. <p>Klienti do të informohet për vlerën e përafërt të NEI në momentin e aplikimit dhe gjithashtu për vlerën e saktë në disbursimin e fondeve (me Aneksin e Planit të Pagesës).</p> <p>Pas disbursimit të kredisë aplikanti do të pajiset me Aneksin e Planit të Pagesës në të cilën është shprehur në % Norma Efektive e Interesit (NEI) e cila i referohet vlerës së normës bazë (Bono Thesari 1-vjeçare) sipas kushteve të tregut në momentin në të cilin realizohet disbursimi i kredisë.</p>																		
<p>8. Vlera e kredisë dhe monedha e ofruar</p>	<p>Shuma maksimale e kredisë – Deri në 100,000,000 LEK, 1,000,000 EUR ose 1,000,000 USD</p> <p>Monedha e kredisë :</p> <ol style="list-style-type: none"> 1- Kredi me Peng Depozite: Lek, Euro, Dollar Amerikan 2- Kredi përkundrajt Bonove të Thesarit dhe Letrave me Vlerë: LEK 																		

<p>9. Kohëzgjatja e kontratës së kredisë me Peng Depozite, B. Thesari, Obligacioni</p>	<p>Afati maksimal varet nga qëllimi i përdorimit të kredisë dhe monedha</p>
<p>10. Kredia është në monedhë të ndryshme nga ajo në të cilën konsumatori gjeneron të ardhurat</p>	<p><input type="checkbox"/> Kredia është në monedhë të ndryshme nga të ardhurat e Klientit; <input type="checkbox"/> Kredia është në të njëjtën monedhë me të ardhurat e Klientit;</p>
<p>11. Vlera e këstit të kredisë, e shprehur në monedhën në të cilën konsumatori gjeneron të ardhurat, mund të ndryshojë.</p>	<p>Banka do të njoftojë klientin në rastet kur, si rezultat i ndryshimit të kursit të këmbimit, kësti i kredisë do të rritet me 20% se kundërvlera e këstit që do të rezultonte nëse do të aplikohesh kursin e këmbimit midis monedhës së kredisë dhe monedhës në të cilën klienti gjeneron të ardhurat, në datën e nënshkrimit të kontratës. Klientit i jepet mundësia e konvertimit të kredisë në monedhën që gjeneron të ardhura. Kërkesa për konvertim do të jetë subjekt vlerësimi nga ana e Bankës në përputhje me dokumentacionin financiar që Kredimarrësi do të depozitojë në momentin e paraqitjes së kërkesës me shkrim dhe, nëse plotësohen kushtet e kreditimit, konvertimi do të kryhet me kursin zyrtar të Bankës në ditën që kryhet konvertimi.</p>
<p>12. Çelja dhe Lëvrimi i Kredisë</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Si kusht për lëvrimin e kredisë, Kredimarrësi do të hapë një ose më shumë llogari rrjedhëse pranë Bankës Kombëtare Tregtare, e quajtur "llogaria e kredisë", në të cilën Banka do të bëjë disbursimin e fondeve dhe nëpërmjet së cilës do të bëhet ripagimi i kredisë. - Tërheqja e kredisë do të bëhet në një nga mënyrat: me anë të tërheqjes në të holla, me anë të tërheqjes me mjete elektronike, me anë të një çeku të lëshuar nga vetë klienti mbi bankën, me anë të urdhër-pagesës së dhënë me shkrim në favor të të tretëve. - Kur gjatë disbursimit Banka konstaton se Kredimarrësi ka dalë jashtë kushteve të parashikuara në Kontratën e Kredisë nënshkruar nga palët, Banka ka të drejtë të kërkojë zgjidhjen e kësaj kontrate që do të shoqërohet me kthimin e shumave të përdorura deri në atë moment dhe interesin përkatës.
<p>13. Numri dhe frekuenca e pagesave</p>	<p>Shlyerja e kredisë do të kryhet me këste mujore të barabarta ose të ndryshueshme. Numri i kësteve varion sipas afatit të maturimit.</p>
<p>14. Vlera e çdo kësti për shlyerjen e kredisë me Peng Depozite, B. Thesari, Obligacioni</p>	<p>Sipas mënyrës së shlyerjes: 1- Këste të barabarta mujore = Shuma e kryegjësë + shumën e interesit 2- Këste të ndryshueshme mujore = shuma e interesit mujor + kryegjë (kryegjësja mund të paguhet çdo 1,3,6,12 muaj ose në maturimin e kredisë)</p>

Kushtet e kredisë dhe llogarita e NEI-së

Shuma e kredisë	1,000,000	ALL
Maturiteti	121	Muaj
Lloji I Kredisë	Kredi me Peng Depozite	
Lloji I Interesit	Fiks per 5 vitet e para	

Norma e Interesit	Norma e Depozites	Norma Baze (B-TH)	Marzhi	Minimum 5 vitet e para	Minimum pas 5 viteve
4.60%	3.10%	3.71%	1.50%	0.00%	4.00%
Komision disbursimi			0.5%		ALL
Kësti mujor				10,344.32	ALL
Vlera Totale në fund të periudhës (Kryegjë+Interes)*				1,253,382.11	ALL
Norma efektive e interesit (NEI)				4.73%	

Tabela e amortizimit

Monedha	Shuma e kredisë	Norma e Interesit (ne %)	Maturiteti I kredisë në vite	Maturiteti I kredisë në muaj	Kësti mujor
ALL	1,000,000	4.60%	10.08333333	121	10,344.32
Muaj	Balanca në fillim	Shuma e interesit	Shuma e principalit	Kësti mujor	Balanca në fund
1	1,000,000	3,833.33	6,510.99	10,344.32	993,489
2	993,489	3,808.37	6,535.95	10,344.32	986,953
3	986,953	3,783.32	6,561.00	10,344.32	980,392
4	980,392	3,758.17	6,586.15	10,344.32	973,806
5	973,806	3,732.92	6,611.40	10,344.32	967,195
6	967,195	3,707.58	6,636.74	10,344.32	960,558
7	960,558	3,682.14	6,662.18	10,344.32	953,896
8	953,896	3,656.60	6,687.72	10,344.32	947,208
9	947,208	3,630.96	6,713.36	10,344.32	940,495
10	940,495	3,605.23	6,739.09	10,344.32	933,755
11	933,755	3,579.40	6,764.92	10,344.32	926,991
12	926,991	3,553.46	6,790.86	10,344.32	920,200

*Shuma e totalit të kryegjësë dhe interesat për t'u paguar është llogaritur me normën e mësipërme të interesit. Kjo shumë totale mund të ndryshojë në varësi të ndryshimeve të normës bazë (Bono Thesari/Euribor/Sofr).

Frekuenca e rishikimit të normës bazë të interesit (Bono Thesari/Euribor/Sofr) për periudhën me normë të ndryshueshme, do të jetë çdo 12 muaj të kredisë.

Kjo është një tabelë ilustruese dhe përlllogaritja e kësteve pas 12 muajve të parë të kredisë apo pas periudhës me normë fikse, i referohet normës bazë të interesit që është në fuqi në muajin aktual.

15. Tabela ilustruese e amortizimit të kredisë (plani i shlyerjeve)

16. Kosto shtesë të pakthyeshme në rastin kur aplikohen të tilla

Nuk ka.

17. Kosto shtesë të tjera

Lloji i shpenzimit	Vlera
Shpenzime noteriale *	~ 3.800 Lek/ për kontratë
Shpenzimet e barrësimit**	~ 1.400 Lek
Komision disbursimi	0-0.5% e shumës së kredisë

	<p>* Ky shpenzim është i vlefshëm për kredi me shuma më të mëdha se 5,000,000 Lek/50,000 Euro/ 50,000 USD të siguruara me depozitë dhe për të gjitha kreditë e siguruara me Bono Thesari apo Obligacion .</p> <p>**Ky shpenzim është i vlefshëm për kredi me shuma më të mëdha se 3,000,000 Lek/30,000 Euro/ 30,000 Usd të siguruara me depozitë dhe për të gjitha kreditë e siguruara me Bono Thesari apo Obligacioni.</p> <p>Kostot e mësipërme klasifikohen si kosto pas miratimit të kredisë. Këto shpenzime janë të pashmangëshme dhe të detyrueshme para disbursimit të kredisë. Shpenzimet e noterizimit të kontratave të kredisë, barrësimit të pengut dhe komisioni i angazhimit ekzekutohen vetëm një herë.</p>
18. Shlyerja para afatit të maturimit (kur është e aplikueshme)	Banka pranon shlyerje të parakohshme të kredisë pa kosto shtesë për klientin, të barabartë me 0% të shumës së papaguar.
19. Penalitetet për pagesat në vonesë	<p>Në rast se Kredimarrësi është në pamundësi për të ripaguar në kohë këstin e maturuar (interesin ose kryegjënë), Banka përveç normës së interesit normal, ka të drejtë të aplikojë penalitet në masën 4 (katër)% në Lekë dhe 3 (tre)% në Euro/Dollar Amerikan në muaj, i llogaritur mbi detyrimin e këstit të rradhës së pa paguar (kryegjë + interes) për periudhën në të cilën ai është më vonesë në bazë të kushteve të kësaj kontrate.</p> <p>Shuma në vonesë x normën e penalitet% x 12 muaj / 360 ditë x ditët në vonesë</p>
20. Penalitete të tjera	<p>- Në rast se Banka zbulon që kredia nuk është përdorur për qëllimin e akorduar, atëherë ajo ka të drejtë që të kërkojë menjëherë rikthimin e kredisë dhe interesave të akumuluar, ose në rast se e gjykon të arsyeshme në vend të aplikimit të veprimit të sipër përmendur, mund të aplikojë 1% penalitet mbi shumën fillestare të kredisë.</p> <p>- Në rast të mospagimit të komisioneve dhe interesit, Banka ka të drejtë të aplikojë një penalitet prej 4 (katër)% në Lekë dhe 3 (tre)% në Euro/Dollar Amerikan, në muaj, mbi shumën e papaguar të komisionit dhe interesit.</p>
22. Njoftimi zyrtar midis palëve	Të gjithë njoftimet, komunikimet midis palëve do të bëhen me shkrim dhe me pëlqimin e dy paleve të dorëzuara personalisht ose me postë të regjistruar (rekomandë) në adresën e përcaktuar në Kontratën e Kredisë ose kur është e mundur me një mjet të qëndrueshëm komunikimi (e-mail përcaktuar në Kontratën e Kredisë, disketë, CD-ROM, DVD) . Kredimarrësi/Dorëzanësi deklaron dhe pranon që të gjithë llojet e njoftimeve të bëra në këto adresa do të konsiderohen si të marra nga ai. Klienti mund t'i paraqesë Bankës reklamimet e tij, për sa njoftohet, brenda një afati prej 15 ditësh kalendarike. Kredimarrësi/Dorëzanësi është i detyruar që për çdo ndryshim në adresat e tij të njoftojë Bankën brenda 15 ditëve kalendarike për këto ndryshime. Për sa kohë që ai nuk ka njoftuar adresën e re, Kredimarrësi nuk ka të drejtë të kundërshtojë njoftimet e bëra në adresën e mëparshme.
23. E drejta e tërheqjes nga kontrata e kredisë	Klienti ka të drejtë të tërhiqet nga kontrata e Kredisë brenda një periudhe kalendarike 14 ditore. Ky afat fillon nga data e nënshkrimit të kësaj kontrate. Në rastet kur shuma e kredise është disbursuar në llogarinë e klientit dhe ky i fundit ushtron të drejtën për t'u tërhequr nga Kontrata e Kredisë, atëherë klienti pranon dhe merr përsipër të shlyejë kryegjënë dhe gjithë detyrimet për interesa

Nr. Referencës :

RBG.2-F-015

Data Rishikimit :

09/05/2024

	<p>dhe /ose penalitete, si dhe shpenzime të tjera të mundshme të bankës të krijuara me palë të treta për efekt të disbursimit të kësaj shume. Nëse kredimarrësi tërhiqet nga kontrata e kredisë, edhe bashkëkredimarrësi ose dorëzanësi gjithashtu, tërhiqet nga kontrata e kredisë ose tërheq garancinë/të e vendosura prej tij për ekzekutimin e kontratës.</p>
24. Mundësia e zëvendësimit të kolateralit	<p>Në çdo rast kolaterali i ri i propozuar nga ana e klientit duhet të plotësojë kushtet e kredidhënies së Bankës të aplikueshme për këtë produkt kredie në momentin e shqyrtimit të kërkesës. Kolaterali që ofrohet për zëvendësim do të jetë subjekt vlerësimi nga Banka si në aspektin ligjor si dhe të vlerës që pasuria ka në treg. Nëse pasuria e propozuar për zëvendësim nuk plotëson kushtet e kërkuara nga banka, banka ka të drejtë të refuzojë kërkesën e klientit për zëvendësim të kolateralit.</p> <p>Kredimarrësi pranon që për kërkesën e bërë për zëvendësim do t'i paguajë Bankës një komision, vlera e së cilës është e publikuar në kushtet e punës së Bankës, në momentin e bërjes së kërkesës, pavarësisht faktit nëse kërkesa miratohet ose jo nga Banka.</p> <p>Nëse ndryshimi në termat dhe kushtet kontraktore do të kërkohet nga Banka, atëherë nuk do të aplikohet komision.</p>
25. Skemat e brendshme të ankimit	<p>Klientët kanë mundësi të depozitojnë një ankesë apo sugjerim përmes kanaleve të mëposhtëm:</p> <ul style="list-style-type: none">- Paraqitja e kërkesës me shkrim pranë çdo dege.- Vizitë pranë çdo degë.- Nëpërmjet telefonit (+355 42 266 288) call center- Nëpërmjet adresës elektronike info@bkt.com.al- Nëpërmjet Aplikacionit BKT Smart- Nëpërmjet Postës Zyrtare- Nëpërmjet formës së dedikuar në faqen zyrtare të BKT-së- Nëpërmjet formularit të ankesave dhe sugjerimeve në Facebook
26. Periudha kohore e vlefshmërisë së informacionit parakontraktor	<p>Periudha kohore e vlefshmërisë së informacionit parakontraktor është 7(shtatë) ditë kalendarike nga data e nënshkrimit të këtij informacioni nga klienti</p>

_____/_____/_____/_____
(Qyteti, dd,mm,vvvv)

Klienti: Emër Mbiemër
(Firma)